

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA HANI I ELEZIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **659-26-968-2-3-6**

Sa i përket tenderit për **Transmetimi i drejtëpërdrejtë i seanceve të Kuvendit Komunes së Hanit të Elezit 2026-2027**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	VILA STUDIO SH.P.K.
NUI	811559709
Adresa	fsh. Gorance, Hani i Elezit
Vendi	Hani i Elezit
Kodi postar	71510
Numri Telefonit	+38349541616
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Afrim Vila
Adresa elektronike	afrimvila@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	09.04.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit	Ferizi L.L.C
Adresa e plotë	Rr.Perandori Justinian Prishtine
Numri i Telefonit	+3834961466
Numri i faks-it	
Adresa elektronike	taulant@nuvialegal.com

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Transmetimi i drejtëpërdrejtë i seancave të Kuvendit Komunes së Hanit të Elezit 2026-2027

Autoriteti kontraktues Komuna e Hanit të Elezit ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me nr. 659-26-968-2-3-6, me titull:"Transmetimi i drejtëpërdrejtë i seancave të Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit 2026–2027",përmes procedurës së Kuotimit të Çmimit – vlerë e ulët.

1. Ne, si operator ekonomik, kemi dorëzuar ofertë brenda afatit ligjor dhe kemi marrë pjesë në procedurë.

2. Sipas Procesverbalit të hapjes së tenderëve (B12), oferta jonë rezulton të jetë më e ulëta në çmim në raport me operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës.

3. Pas hapjes së ofertave, autoriteti kontraktues ka nxjerrë vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

4. Në njoftimin për anulim nuk është dhënë arsytim i mjaftueshëm dhe i bazuar në dispozitat ligjore përkatëse.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Operatori ekonomik ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, duke kontestuar në mënyrë të argumentuar vendimin e marrë dhe duke paraqitur pretendime konkrete për shkelje ligjore në këtë procedurë të prokurimit.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar këtë kërkesë për rishqyrtim në mënyrë formale dhe pa e trajtuar në thelb, duke mos adresuar pretendimet konkrete të paraqitura nga operatori ekonomik dhe duke mos ofruar arsyetim të mjaftueshëm dhe të bazuar në ligj.

Ky veprim është në kundërshtim me nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili garanton të drejtën e operatorëve ekonomikë për mjete efektive juridike dhe obligon Autoritetin Kontraktues që të shqyrtojë në mënyrë të drejtë, objektive dhe të arsyetuar kërkesat për rishqyrtim.

Dështimi i Autoritetit Kontraktues për të zhvilluar një shqyrtim substancial të kërkesës për rishqyrtim dhe për të dhënë një vendim të arsyetuar përbën shkelje të drejtpërdrejtë të të drejtës për mjete juridike efektive, si dhe cenon parimet themelore të transparencës, trajtimit të barabartë dhe sundimit të ligjit në procedurat e prokurimit publik.

Për rrjedhojë, refuzimi i kërkesës për rishqyrtim paraqet një veprim arbitrar dhe të pajustificuar, duke e detyruar operatorin ekonomik që të ushtrojë të drejtën e tij për ankesë pranë organit kompetent, në mënyrë që të sigurojë mbrojtje efektive të të drejtave dhe interesave të tij legjitime.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1.Neni 1 dhe 6 – Qëllimi dhe ekonomiciteti ? Përdorimi efikas i fondeve publike është obligim ligjor. - Refuzimi i ofertës më të lirë pa arsye mund të konsiderohet shkelje e parimit të ekonomicitetit.

2.Neni 7 – Parimet e përgjithshme AK është i obliguar të respektojë: ? Transparencën ? Trajtimin e barabartë ? Mosdiskriminimin ? Konkurrencën e ndershme -Nëse aktiviteti është anuluar pa arsyetim të qartë dhe të bazuar, sidomos kur ekziston ofertë më e lirë, kjo

mund të përbëjë shkelje të këtyre parimeve.

3.Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve:Në përputhje me nenin 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues ka për obligim që të kryejë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave në mënyrë të drejtë, objektive dhe të paanshme, duke u bazuar ekskluzivisht në kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit.

Ky nen gjithashtu obligon Autoritetin Kontraktues që kontrata t'i jepet ofertës ekonomikisht më të favorshme, përkatësisht ofertës me çmimin më të ulët në rastet kur ky është kriteri i dhënies së kontratës, me kusht që oferta të jetë e përgjegjshme dhe në përputhje me kërkesat e tenderit.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka zhvilluar procedurën deri në fazën e hapjes së ofertave, duke krijuar kështu obligimin ligjor për të vazhduar me procesin e ekzaminimit, vlerësimin dhe krahasimin të tyre, në përputhje me nenin 59 të LPP-së.

Megjithatë, anulimi i procedurës në këtë fazë, pa përfunduar procesin e vlerësimin dhe pa ofruar arsye të qarta, konkrete dhe të bazuara ligjërisht, përbën shmangie nga obligimet e përcaktuara në nenin 59 të LPP-së dhe cenon drejtpërdrejt integritetin e procesit të prokurimit.

Një veprim i tillë krijon dyshime të bazuara se Autoriteti Kontraktues ka dështuar të zbatojë në mënyrë të drejtë dhe të plotë procedurat ligjore për vlerësimin e ofertave, duke devijuar nga parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së drejtë ndërmjet operatorëve ekonomikë.

4.Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit:Përkundër kësaj, Autoriteti Kontraktues ka vendosur të anulojë procedurën duke u bazuar në një arsyetim të përgjithshëm lidhur me një gabim të pretenduar në paramasë dhe paralogari, sipas kërkesës së njësisë kërkuese. Një arsyetim i tillë është i paqartë, i paargumentuar dhe nuk përmbush standardet ligjore të përcaktuara në nenin 62 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik.

5.Nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili garanton të drejtën e operatorëve ekonomikë për mjete efektive juridike dhe obligon Autoritetin Kontraktues që të shqyrtojë në mënyrë të drejtë, objektive dhe të arsyetuar kërkesat për rishqyrtim.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Bazat ligjore dhe parimet e shkelura:

1. Neni 1 – Qëllimi i Ligjit

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik ka për qëllim të sigurojë që prokurimi publik të zhvillohet në mënyrë të **transparente, konkurruese dhe efikase**, duke mbrojtur interesat publike. Vendimi për anulim, pa një arsyetim ligjor dhe të dokumentuar, cenon këtë qëllim dhe dëmton interesin publik.

2. Neni 6 – Parimet themelore të prokurimit

Autoriteti Kontraktues është i obliguar të zbatojë parimet themelore të prokurimit publik, duke përfshirë **ligjshmërinë, paanshmërinë, dhe përdorimin efikas të fondeve publike**. Anulimi i procedurës pa arsye të qarta dhe të dokumentuara bie ndesh me këto parime.

3. Neni 7 – Transparenca, trajtimi i barabartë dhe konkurrenca e ndershme

Parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së ndershme janë thelbësore për besueshmërinë e procedurave të prokurimit. Vendimi për anulim, i paarsyetuar dhe i paprovuar, bie ndesh me këto parime, duke krijuar trajtim të pabarabartë për operatorët ekonomikë.

4. Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave

Autoriteti Kontraktues ka për obligim të kryejë **vlerësimin objektiv dhe të drejtë të ofertave** dhe të japë kontratën ofertës **ekonomikisht më të favorshme**, ose me çmimin më të ulët, në rastin kur ky është kriteri i tenderit. Oferta jonë ka rezultuar të jetë më e ulëta dhe nuk ka pasur arsye të dokumentuar për refuzimin ose eliminimin e saj. Anulimi i procedurës në këtë fazë përbën shkelje të këtij neni.

5. Neni 62 – Anulimi i aktiviteteve të prokurimit

Anulimi i një procedure është i lejuar vetëm në rrethana të justifikuara dhe të arsyetuara qartë. Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk ka ofruar asnjë provë apo dokument që justifikon anulimin, duke e bërë vendimin të **kundërligjshëm dhe arbitrar**.

6. Neni 108/A – Mjete juridike efektive

Ligji garanton operatorëve ekonomikë **mjete juridike efektive** për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre legjitime. Mospranimi i ofertës sonë pa arsye ligjore të dokumentuar përbën shkelje të nenit 108/A, duke mohuar mbrojtjen efektive të të drejtave të operatorit ekonomik.

7. Parimi i ekonomicitetit dhe përdorimit efikas të fondeve publike

Autoriteti Kontraktues ka detyrim që të zgjedhë ofertën më të lirë financiare, në përputhje me **parimet e ekonomicitetit dhe efikasitetit**. Moszgjedhja e ofertës sonë, pa arsye ligjore, cenon këto parime dhe përdorimin e përgjegjshëm të fondeve publike.

Përfundim:

Duke pasur parasysh sa më sipër, vendimi i Autoritetit Kontraktues për anulim, pas hapjes së ofertave dhe pa një arsyetim të qartë dhe të dokumentuar, konsiderohet i **kundërligjshëm, i padrejtë dhe në shkelje të nenëve 1, 6, 7, 59, 62 dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik**.

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale të shkaktuara

Si rezultat i veprimeve të autoritetit kontraktues Komuna e Hanit të Elezit, përkatësisht anulimit të paarsyetuar të aktivitetit të prokurimit me nr. 659-26-968-23-6, ne si operator ekonomik kemi pësuar dëme materiale si në vijim:

1. Shpenzimet për përgatitjen e ofertës

**Kosto për përgatitjen e dokumentacionit administrativ dhe teknik;
Angazhimi i stafit profesional për hartimin e ofertës, kerkese per rishqyrtim, ankese si dhe shpenzime operative (printim, noterizim, transport, etj.).**

2. Humbja e mundësisë për përfitim (fitimi i munguar)

Duke qenë se oferta jonë ka qenë më e ulëta në çmim, ne kemi pasur gjasa reale për fitimin e kontratës; Anulimi i padrejtë na ka privuar nga realizimi i të ardhurave dhe fitimit të pritshëm nga ky kontraktim.

3. Shpenzimet e pjesëmarrjes në procedurë

**Koha dhe resurset e dedikuara për ndjekjen e procedurës së prokurimit;
Angazhimi në komunikim dhe përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktues.**

4. Dëmtimi ekonomik indirekt

Bllokimi i kapaciteteve tona për këtë projekt gjatë periudhës së zhvillimit të procedurës; Humbja e mundësive tjera për angazhim në projekte alternative.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*